

Huaja për Albchrome ndaj Yildirim Holding

Vendi: SHQIPËRI

NUMËR PROJEKTI: 53212

Sektori i Biznesit: Burimet Natyrore

Lloji i Njoftimi: PRIVAT

Kategoria Mjediore: B

Data e synuar e aprovimit: 27 Prill 2022

Statusi: Në Pritje për Aprovim

Publikimi i DPP: 07 Mars 2022

Përshkrimi i Projektit

Hua e siguruar deri në US\$ 28 milion për Yildirim Albanian Mining Investments Sh.p.k. dhe Albchrome Sh.p.k. me qëllim blerjen e Albchrome Holding Sh.p.k. nga Yildirim Holding A.S. Huaja do të konsistojë në dy komponentë: Komponenti A deri në US\$ 8,400,000 që do të ofrohet për ri-financimin e borxhit ekzistues të Albchrome në datën e blerjes dhe Komponenti B deri në US\$ 19,600,000 që do të përdoret për të ri-financuar pjesërisht fondet e Grupit të përdorura për paradhënien e blerjes.

Objektivat e Projektit

Pronarët e rinj do të sjellin tek Albchrome një mundësi për të shpërndarë produktet e saj tek një klientelë më e gjerë dhe e diversifikuar ndërsa Albchrome do të përfitojë nga ekspertiza menaxheriale dhe teknike e Yildirim për sa i përket optimizimit të operacioneve dhe përcimit të aftësive. Pjesëmarrja e Bankës do të kontribuojë në zhvillimin e një udhërrëfyesi për Karbon të ulët dhe Përshtatje me Klimën për Albchrome. Projekti është në përputhje të plotë me Strategjinë e Bankës për Shqipërinë (2020-2025) e cila identifikon promovimin e efikasitetit të energjisë dhe rritjen e konkurencës së sektorit privat si prioritet strategjik në vend dhe me Strategjinë për Industrinë Minerare Nxjerrëse (2018-2022) e cila mbështet përmirësimin e efikasitetit operacionale në projektet minerare and nxjerrjen e metaleve kryesore për sektorin e ndërtimit dhe industrinë e energjisë së rinovueshme. Krahas kësaj, Projekti është në përputhje të plotë edhe me Qasjen e Bankës për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër (2021-2025) (BDS20-082/F).

Ndikimi në Tranzicion

ETI 73

Mirë-qeverisja:

Projekti do të mbështesë Albchrome në përpjekjet e tij për të zhvilluar një udhërrëfyes të orientuar nga ndryshimet klimatike me fokus në implementimin e mirëqeverisjes ndaj klimës për korporatat (MKK) dhe adoptimin e teknologjive klimatike. Albchrome do të zhvillojë dhe adoptojë një plan strategjik drejt përmirësimit të strukturës dhe proceseve të MKK dhe për marrjen e masave efektive për klimën.

Gjithëpërfshirëse:

Albchrome do të promovojë qasjen në aftësi dhe mundësi punësimi për punonjësit e industrisë përreth minierave, fabrikave, ndërmarrjeve në zonat më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Kjo do të arrihet përmes prezantimit të një programi të ri të çertifikuar që do t'u lejojë punonjësve lokalë, përfshirë shumicën e punonjësve më të vjetër të fitojnë njohuritë e duhura për tregun si aftësitë dixhitale. Projekti do të gjenerojë mundësi përvetësimi njohurish për 120 punonjës lokalë përfshirë të paktën 20 për qind pjesëmarrje femërore dhe përmban bashkëpunim me qendra trainimi lokale dhe shkollat teknike.

Informacion për Klientin

YILDIRIM ALBANIAN MINING INVESTMENTS SHPK

Yildirim Albanian Mining Investments Sh.p.k, është një kompani shqiptare, 100% në pronësi të Yildirim International Investment Holding BV, degë e Yildirim Holding A.S., një konglomerat industrial turk vertikalisht i integruar dhe Albchrome Sh.p.k., një kompani minerare shqiptare.

Përmbledhja e Financimit të BERZH

USD 28,000,000.00

Hua e siguruar deri më USD 28 milion.

Kostoja Totale e Projektit

USD 97,670,500.00

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategorizuar B (2019 ESP). Vlerësimi i impaktit mjedisor dhe social (VIMS) u krye nga DMS dhe përfshin një përmbledhje të dokumenteve të VIMS të përgatitura për transaksionin me Albchrome në 2021, si dhe intervista me drejtuesit e Yildirim. Risku Mjedisor dhe Social dhe impakti që lidhet me blerjen e kompanisë minerare dhe operimin e dy fabrikave ekzistuese të ferrokromit dhe një miniere janë lehtësisht të identifikueshme dhe do të menaxhohen përmes zbatimit të një Plani të fortë Masash Mjedisore dhe Sociale (PMMS). Risku kryesor lidhet me emetimet në ajër nga furnalatat (dhe përputhjen me Teknikat më të Mira të Disponueshme) dhe shëndeti në punë e siguria (veçanërisht në operacionet nëntokësore). Ky risk do të menaxhohet nga Plani i Masave Mjedisore dhe Sociale (PMMS). Yildirim ka konfirmuar angazhimin e tij për të zbatuar PMMS të dakordësuar në 2021 me Albchrome. Një vlerësim i impaktit Mjedisor dhe Social i zhvilluar në tremujorin e parë të 2021 nga një konsulent i pavarur (përfshirë një vizitë në njësi nga ekipi vendas) tregoi se Albchrome vepron në përputhje me kriteret shqiptare por duhet t'i përshtasë sistemet e menaxhimit Mjedisore dhe Sociale me Kriteret e Performancës së Bankës. Shoqëria konfirmoi se të gjithë degët e Yilmaden duhet të zhvillojnë procedurat e tyre, për këtë arsye Albchrome duhet të zhvillojë të gjithë procedurat e nevojshme duke mbajtur në konsideratë vlerësimin e riskut, kërkesat ligjore dhe kërkesat e BERZH. Yildirim kreu një Vlerësim të Impaktit Mjedisor dhe Social të tijin në momentin e blerjes dhe gjetjet e tyre u njësuat me PMMS të BERZH.

Albchrome ka një strukturë që siguron përputhshmëri me kuadrin rregullator kombëtar. Të gjitha lejet për zhvillimin e aktivitetit në Shqipëri janë marrë. PMMS kërkon zhvillimin e një sistemi menaxhimi të integruar mjedisor dhe social, për shëndetin, sigurinë (përfshirë menaxhimin e riskut për furnitorët dhe nënkontraktorët) dhe caktimin e punonjësve të specializuar për Shëndetin, Sigurinë, Mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale në nivel korporate dhe në vendin e punës. Një menaxher

për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë në Punë i caktuar nga Yilmaden do të mbajë pozicionin e menaxherit derisa një person i përhershëm të punësohet. Pozicioni do të shpallet së shpejti dhe publikimi i njoftimit do të jetë kusht për disbursimin e parë. Albchrome ka politika të shkruara për burimet njerëzore për menaxhimin e fuqisë punëtore në përputhje me kriteret kombëtare. Në tre njësitë e prodhimit ekzistojnë kontrata kolektive dhe 96% e punonjësve raportohet të jenë anëtarë të Sindikatës. Punonjës që u intervistuan në mënyrë rastësore gjatë VIMS treguan se ata janë të kënaqur me pagën dhe jetë-gjatësinë (stabilitetin) e punës. Një mekanizëm formal ankimimi do të krijohet sipas kërkesave të PMMS. Rezultatet e pyetësorit për COVID-19 konfirmuan se Albchrome nuk planifikon shkurtime në staf apo reduktim të pagës dhe se janë marrë masat për të kufizuar përhapjen e COVID-19 (sipas udhëzimeve kombëtare). Gjatë intervistës për Vlerësimin e Impaktit Mjedisor dhe Social, Yildirim konfirmoi se nuk ka në plan për momentin për largime kolektive nga puna. Nëse do të ndodhin ristrukturime të mëdha, Shoqëria do të duhet të sigurohet se masa të tilla do të merren në përputhje me PR2 dhe duke njoftuar paraprakisht BERZH.

Dy furnaltat nuk janë aktualisht të pajisura me një sistem të reduktimit të emetimeve të ajrit dhe një analizë e mangësive (e zhvilluar gjatë VIMS2021) tregoi se përkundrejt Teknikave më të Mira të Disponueshme furnaltat nuk janë në përputhje me to sipas përshkrimit në Dokumentin Europian të Referencës për industrinë e metaleve jo-hekur (2017). PMMS kërkon i) instalimin e sistemeve të reduktimit të pluhurit në të dy furnaltat, ii) zhvillimin dhe zbatimin e një plani masash që sigurojnë përfrimin me Teknikat më të Mira të Disponueshme, iii) përforcimin e protokollove të monitorimit (ajër, shëndet, zhurmë, ujë), iv) vlerësimin e emetimeve të gazrave serë, v) testin e shpëlarjes së skorjeve. Në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë nevojiten disa përmirësime sipas PMMS si vlerësimi i higjenes industriale në ambientet kryesore të punës dhe përmirësimi i kushteve në stacionet e nëndheshme të emergjencës dhe shpëtimit të minierës (dhomat e strehimit) si dhe në zhvillimin e një auditi të jashtëm për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë për njësitë e shkrirjes dhe minierën. Nuk nevojitet blerje toke shtesë për Projektin. Operacionet e Albchrome nuk janë pranë zonave të njohura arkeologjike ose të mbrojtura për biodiversitetin. PMMS kërkon rekrutimin një Punonjësi për Marrëdhëniet me Komunitetin dhe zbatimin e një Plani të Angazhimit të Palëve të Interesit (përfshirë një mekanizëm ankimimi për komunitetin). Shoqëria ka rënë dakort të publikojë përmbledhje të rezultateve vjetore të performancës së tyre mjedisore dhe sociale në faqen e tyre të internetit.

Projekti vlerësohet në përputhje me objektivat e Marrëveshjes së Parisit për zbutjen e ndikimeve të Klimës. Projekti vlerësohet në përputhje me Marrëveshjen e Parisit për përshtatje ndaj ndikimeve të klimës. Risku fizik klimatik është vlerësuar 1 duke qenë se Risku i Transferuar tek Palët është i diversifikuar dhe nuk konsiderohet se është i ekspozuar në mënyrë thekbësore ndaj riskut fizik të klimës. Si pasojë e sektorit dhe riskut të identifikuar gjatë VIMS për Projektin, Banka duhet të monitorojë zbatimin e PMMS përmes raporteve vjetore mjedisore dhe sociale dhe komunikimit me Shoqërinë e vizitave sipas nevojës.

Bashkëpunimi teknik

Përgatitja një Udhërrëfyese për Karbon të Ulët dhe Përshtatja Klimatike. Objektivi kryesor është të asistohet Albchrome në zhvillimin e një udhërrëfyese me një plan të detajuar masash për të realizuar zbatimin e praktikave më të mira për Mexhamin e Klimës dhe zhvillimin e një strategjie për klimën. Burimi i fondeve do të jetë Fondi i Veçantë i Aksionerëve të BERZH.

Vlera e shtuar

Për Bankën kjo vjen nga: i) mungesa e një financimi afat-gjatë në vend në investime për industrinë vendase minerare, ii) mbështetja e Bankës në arritjen e standarteve më të larta përmes zhvillimit

dhe zbatimit të një Plani Masash Mjedisore dhe Sociale, iii) mbështetja e Bankës për zhvillimin e një plani të mirëqeverisjes së korporatës për klimën (udhërrëfyese për ndryshimet klimatike).

Informacion kontakti për Shoqërinë

Serdar Ates, Structured Finance Manager Yildirim Holding A.S.

serdar.ates@yildirimgroup.com

+90 212 290 30 80

YILDIRIM Tower, Maslak Mahallesi, Tasyoncasi Sok. No:1C B2 Blok, 34485 Sariyer / Istanbul Turkey

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Të gjithë klientët e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efektive për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktikën mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpall informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Llogaridhënien mbi Projektin (MPLLP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projektit të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Llogaridhënien ndaj Projektit (MPLLP) të BERZH.

MPLLP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe çdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Llogaridhënien ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPLLP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPLLP përmes emailit jpam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.